



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 19235 Prot.

Vlorë, më 17.11 . 2025

PROJEKTVENDIM


**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS TË AKTIVITETEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE PËR PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2026”**

Në mbështetje të Nenit 8 pika 2, Nenit 9 pika 1 nënpika 1.1 gërma b, Nenit 54 pika k dhe n, të Ligjit Nr.139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Nenit 118, të Rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë”, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve të Këshillit të Bashkisë si dhe, në relacionin e paraqitur nga Sekretari i Këshillit, Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e tij të datës....

VENDOSI:

1. Të miratojë programin e aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën Janar-Dhjetor 2026, sipas planit të aktiviteteve bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Këshilli dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 55, pika 6.

**KRYETAR
Elpiniq Mërkuri**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 18235 Prot.

Vlorë, më 17.11.2025

RELACION

Mbi projektvendimin “Për miratimin e Programit të Punës të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë për vitin 2026”.

Para : Këshillit të Bashkisë

Të nderuar Keshilltarë!

Sikurëse jeni në dijeni në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” neni 118 është parashikuar miratimi brënda muajit nëntor të cdo viti, i programit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë për vitin pasardhës. Projektvendimi që ju paraqesim për miratim, lidhet me programin e aktiviteteve të këshillit të bashkisë, për vitin 2026, i cili është një dokument i rëndësishëm, që orienton procedurat vendimmarrëse, për të zbatuar sa më mirë dispozitat ligjore, për të marrë vendime sa më të drejta për qytetarët, si dhe për të bërë objekt shqyrtimi në Këshillin e Bashkisë, problematika të ndryshme në shërbim të Komunitetit.

Programi i punës , ka në përbërjen e vet një plan aktiviteteve mujore, bazuar kjo në detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore në fuqi ,si dhe, në Rregulloren, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë”.

Në muaj të ndryshëm janë parashikuar çështje të ndryshme siç janë: Projektakte të propozuara për miratim,si ato të ndihmës ekonomike të buxhetit vjetor si dhe, të PBA 2027-2029.

Gjithashtu, janë parashikuar edhe informacione ose raporte të ndryshme nga drejtoritë ose institucione në varësi të bashkisë etj.

Gjithashtu, programi i aktiviteteve ka në përbërjen e vet një program konsultimi me publikun, bazuar në Ligjin për Konsultimin, Neni 16 dhe 18 i Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, detyron këshillin bashkiak të organizojë konsultime publike për vendimet që merr, lidhur me Buxhetin Vjetor, Projekt Buxhetin Afatmesëm, si dhe çështje të tjera që lidhen me pikat “a”, “dh”, “e”, “f”, dhe “k” të Nenit 54 të Ligjit të sipërcituar.

Theksojmë gjithashtu se, ky program aktiviteteve është konsultuar paraprakisht edhe në Konferencën e Kryetarëve të Këshillit të Bashkisë, dhe i paraqitet për miratim Këshillit pasi ka marrë dakortësinë e kësaj strukture të Këshillit të Bashkisë.

Është e kuptueshme se ky program vjetor aktiviteteve, nuk mund të parashikojë gjithë veprimtaritë që zhvillon Këshilli i Bashkisë, në një periudhë 1-vjeçare. Kjo pasi, sikurse është konstatuar gjatë vitit 2025 për bashkinë, dalin problematika të ndryshme të cilat kërkojnë vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë. Por, sidoqoftë, do të shërbejë si një orientues për Këshillin e Bashkisë, lidhur me procedurat e organizimit dhe funksionimit gjithë vjetor. Theksojmë gjithashtu se, këshilltarëve ju është kërkuar të evidentojmë çështje që mendojnë se janë të rëndësishme për tu përfshirë në këtë program aktiviteteve, pavarësisht parashikimeve të këtij projekti. Këshilltarët mund të bëjnë propozime të tjera sidomos, për të trajtuar problematika të ndryshme të konstatuara prej tyre, të cilat duhet të përmirësohen. Kjo, pasi, ky program i jep mundësinë këshillit, por edhe administratës së bashkisë që, të parashikojnë në kohë çështje për diskutim, analizë dhe vendimmarrje, duke evituar trajtimin e tyre vetëm në pikën, "të ndryshme" të rendit të ditës të mbledhjes së këshillit.

Nga sa më lartë, vlerësojmë se, për Këshillin e Bashkisë, si organ vendimmarrës, përfaqësues i komunitetit, ky dokument është i rëndësishëm. Ky program duhet të vlerësohet edhe nga komisionet dhe vecanërisht nga drejtoritë dhe ndërmarrjet e Bashkisë, që ta zbatojnë me korrektesë duke mundur dhe depozitimin e materialeve në kohë dhe në afatin e përcaktuar. E sjellim në vëmendje këtë pasi, gjatë këtij viti ka patur mangësi në mënyrën e dhënies së informacionit për çështjet e parashikuara në planin e aktiviteteve për vitin 2025. Madje, përsa u përket raportimeve ose informacioneve të planifikuara në programin e punës së këshillit për vitin 2025, nga disa drejtori ose struktura të administratës së bashkisë, as që janë paraqitur materialet përkatëse sipas parashikimit në program për Këshillin e Bashkisë. Natyrisht ky program merr parasysh dinamikën e aktiviteteve në komunitet dhe mund të jetë subjekt rishikimi, në vijimësi.

Duke theksuar mundësinë e rishikimit në vijimësi të këtij programi, kërkojmë nga këshilli i bashkisë, ta miratojë atë, me qëllim që të përdoret si orientues i aktiviteteve të këshillit gjatë vitit 2026 si dhe nxitje për administratën e bashkisë në funksion të realizimit të detyrave të bashkisë, si organ i vetëqeverisjes vendore.

Ju faleminderit!

**KRYETARE
ELPINIQI MËRKURI**

Plani i aktiviteteve për vitin 2026

Muaji	Aktivitetet të planifikuara	Autoriteti përgjegjës	Referenca ligjore dhe dokumente të tjera
J A N A R	➤ <i>Veprimtaritë:</i> - Mbledhja e komisioneve të Këshillit Bashkiak - Mbledhja e Këshillit (1) ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1 - Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2 - Miratimi i Tavnave Përgatitore të të Ardhurave për Propozimin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, 3 - Informacion mbi gjendjen dhe funksionimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në Sherishtë.	- K.B - Sekretari - Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. - Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike - Drejtoria e menaxhimit të mbetjeve urbane.	- Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë" - Ligji Nr.68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore"

S H K U R T	➤ <i>Veprimtaritë:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit sipas tematikës së mbledhjes. -Mbledhja e Këshillit (1) ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1- Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Raport mbi performancën e punës në Realizimin e Projekteve në Infrastrukturë të planifikuara për vitin 2025.	K.B -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -D. e Financës - D.Infrastrukturës dhe Investimeve Publike	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
M A R S	➤ <i>Veprimtaritë:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak sipas tematikës së mbledhjes. -Mbledhja e Këshillit.(1) ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1- Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Miratimi i buxhetit faktik i vitit 2025. 3-Miratimi i tavanave përgatitore të PBA 2027-2029 të shpenzimeve për çdo program buxhetor. 4-Raport mbi situatën dhe problematikat e konstatuara në sistemin e vadijes dhe kullimit si dhe masat e parashikuara për të përmirësuar këtë shërbim.	-K.B -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.(Bordi i kullimit)	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" -Ligji 68/2015 - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"

P R I L	➤ <i>Veprimtaritë:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiaak. -Mbledhja e Këshillit.(1) ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1- Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Raport mbi performancën e Shogërive Aksionere në pronësi të Bashkisë Vlorë si dhe të shogërive ku Bashkia Vlorë është aksionere.	-KB -Sekretari -Komisioni për cështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike - Administratorët e Sh.a-ve të Bashkisë.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
----------------------------	--	---	---

M A J	➤ <i>Veprimtaritë:</i> -Mbledhja e Komisioneve të këshillit bashkiak -Mbledhja e Këshillit.(1) ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1- Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Analizë e raportit të 4-mujorit të parë të vitit 2026 të veprimtarisë financiare të Bashkisë.(Raporti i Monitorimit) 3- Informacion mbi masat e marra për mbrojtjen nga zjarret nga MSZH-ja dhe mbi masat e marra për çeljen e sezonit turistik. 4- Informacion mbi problematikat e konstatuara dhe masat e marra për situatën e pastritimit gjatë sezonit turistik.	-KB -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë -Strukturat publike -Strukturat përkatëse të administratës së bashkisë. -Drejtorja e Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit. -Drejtorja e Ndërmarrjes së Pastritimit.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
-----------------------------	--	---	--

Q E R R O R	➤ <i>Veprimtarië:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1 - Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Miratimi i projektit të PBA-së 2027-2029. 3-Raport mbi realizimin e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme të Bashkisë. Problematikat e Konstatuara dhe masat për përfundimin e këtij procesi.	-KB -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -Drejtorja e Procedurave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë" -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore"
---------------------------	--	--	--

K O R R I K	➤ <i>Vepërtaritë:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit bashkiak. -Mbledhja e këshillit . ➤ <i>Tematika e muajit.</i> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Miratimi i Tavanave përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2027-2029 në nivel programi. 3-Raport mbi gjendjen e infrastrukturës në institucionet e arsimit parashkollor, problematikat e konstatuara dhe masat e parashikuara.	-KB -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -Komisioni i arsimit kulturës dhe shëndetit. -Sktori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" - Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
--	---	---	---

G U S H T	➤ <i>Veprimtarië:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit. -Mbledhja e këshillit. ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1- Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Raport mbi gjendjen e infrastrukturës në shkolla dhe masat e marra për vitin e ri shkollor 2026-2027.	-KB -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", -Rregullore "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë"
S H T A O R	➤ <i>Veprimtarië:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit -Mbledhja e këshillit ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Analizë e raportit të 8-mujorit të vitit 2026 mbi realizimin e të ardhurave të bashkisë. 3-Konsultim me publikun për buxhejin e Bashkisë për vitin 2027 si dhe të PBA 2027-2029. 4-Raportet mbi problematikat e konstatuara dhe masat që duhen marrë për zgjidhjen e tyre lidhur me tokat buqësore të dhëna me qira.	-KB -Sekretari -Komisioni për çështjet e Ekonomisë, Financave dhe Privatizimet. -Komisioni Juridik, i Rendit dhe i sigurisë vendore Publike -Drejtoria e Pronave Publike dhe menaxhimit të Aseteve. -Drejtoria e të ardhurave vendore.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" -Ligji 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik". -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore"

T E T O R	➤ <i>Veprimtarië:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit. -Mbledhja e këshillit. ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Raport mbi ecurinë e realizimit të investimeve në infrastrukturë të parashikuara në buxhetin e vitit 2026.	-KB -Sekretari -Komisioni i ekonomisë,financës dhe buxhetit. -Komisioni i gështjeve juridike, rendit dhe sigurisë vendore publike. -Drejtoria e Financës -Drejtoria e Infrastrukturës dhe e Investimeve Publike.	-Ligji 139/2015, 'Për vetëqeverisjen vendore" -Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
N E T O R	➤ <i>Veprimtarië:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit. -Mbledhja e këshillit. Konsultime publike për Paketën Fiskale 2027. ➤ <i>Tematika e muajit:</i> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë. 2-Miratimi i paketës fiskale e vitit 2027. 3-Miratimi i programit të punës të Këshillit të Bashkisë për vitin 2027. 4-Problematikat në lidhje me shërbimet publike si dhe masat për përmirësimin e këtij shërbimi.	-KB -Sekretari -Të gjitha komisionet e këshillit. -Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji 146/2014, "për njoftim dhe konsultim publik". -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetqeverisjes vendore" -Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"

D H J E T O R	➤ <i>Veprimtaritë:</i> -Mbledhja e komisioneve të këshillit -Mbledhja e këshillit ➤ <i>Tematika e muajit.</i> 1-Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar dhe nga të ardhurat e Bashkisë 2-Miratimi i buxhetit të vitit 2027 si edhe PBA-se 2027-2029.	-KB -Të gjitha komisionet -Të gjitha strukturat e administratës së bashkisë.	-Ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" -Ligji 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" -Rregullore "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë"
-----------------------------	--	--	---

Sqarim: Në këtë plan aktivitetesh nuk janë përfshirë çeshtje të ndryshme që mund të vijnë nga administrata e bashkisë, përfshirë dhe ndryshimet e buxhetit.

Gjithashtu, çdo anëtar i këshillit rezervon të drejtën që gjatë vitit të përfshijë tematika dhe çeshtje të ndryshme të cilat ai/ajo mendon se ndikon në përmirësimin e treguesve të performancës së punës së administratës së bashkisë dhe të këshillit në shërbim të komunitetit.

KRYETAR
Elpiniq Merkuri

